



**RAPORTI PËRMBLEDHËS I
MONITORIMIT TË ZBATIMIT
TË MASAVE ANTI COVID-19
NGA SHKOLLAT NË KOSOVË**

SHTATOR-DHJETOR 2020

**RAPORTI PËRMBLEDHËS I
MONITORIMIT TË ZBATIMIT
TË MASAVE ANTI COVID-19
NGA SHKOLLAT NË KOSOVË**

SHTATOR-DHJETOR 2020

Raporti i monitorimit të zbatimit të masave anti COVID-19 nga shkollat në Kosovë gjatë periudhës shtator – dhjetor 2020

Raporti i monitorimit të zbatimit të masave anti Covid-19 nga shkollat në Kosovë shpalos të gjeturat nga monitorimi i 379 shkollave në 34 komuna të Kosovës gjatë periudhës shtator–dhjetor 2020 në katër faza: faza 1 (21 shtator-22 tetor), faza 2 (23 tetor–15 nëntor), faza 3 (16-30 nëntor), dhe faza 4 (1-16 dhjetor). Në tabelën 1 është paraqitur përmbushja e katër masave gjatë secilës fazë, ku vërehet përmirësim i vogël nga faza 1 në fazën 3 dhe përmbushje më e ulët në masën e katërt.

Përmbushja e masave gjatë secilës fazë					Përmbushja mesatare 0.6613 0.9138
Faza	Tipi i masës				
	1	2	3	4	
Faza 1	0.8582	0.8002	0.8235	0.7012	
Faza 2	0.8930	0.8088	0.8328	0.6613	
Faza 3	0.9138	0.8357	0.8787	0.6789	
Faza 4	0.9069	0.8238	0.9003	0.6866	

Tabela 1. Përmbushja e masave gjatë secilës fazë

Duke pasur parasysh se raporti përmbyllës paraqet zbatimin e masave në nivel vendi me mostrën e përfshirë në të gjitha komunat, sipas figurës 1 të paraqitur më poshtë masa 'Taskforca në nivel institucioni parashkollor apo shkolle' është zbatuar më së shumti mesatarisht rreth 89.4%, e përcjellur nga 'Masat parandaluese: testimi, raportimi i rasteve me COVID-19 dhe ndërprerja e mësimi' zbatuar 86%, dhe 'Masat parandaluese higjienike dhe mbrojtëse - Përgatitja e shkollës për fillimin e vitit shkollor' zbatuar 81.7%. Ndërsa, masa e zbatuar më së paku mbetet 'Organizimi i procesit mësimor sipas tre skenarëve të paraqitur në udhëzuesin e MASH' zbatuar vetëm 68%.




Figura 1. Përmbushja e përgjithshme e masave në nivel vendi

Nënmasat e përmbushura më shumë se 95%




Figura 2. Nënmasat e përmbushura më shumë se 95% në nivel vendi

Ky raport poashtu nxjerr edhe nënmasat e zbatuara më pak se 50%. Këto të dhëna janë paraqitur në figurën 3 ku vërehet se nënmasat e zbatuara më së paku në nivel vendi përfshijnë: 'Është mbajtur trajnimi për nxënësit për përdorimin e platformës' zbatuar 26.65%, 'DKA dhe shkolla kanë siguruar transport të sigurtë për grupe të caktuara të nxënësve' zbatuar 35.75%, 'Janë siguruar pajisjet teknologjike për mësimitdhënës' dhe 'Janë siguruar pajisjet teknologjike për nxënësit' zbatuar 37%, 'DKA/Shkolla ka siguruar personel plotësues teknik për m²' dhe 'DKA dhe shkolla kanë siguruar shërbime konsulence psikologjike' zbatuar 45%, 'Është mbajtur trajnimi për mësimitdhënësit për përdorimin e platformës' zbatuar 48.28%, si dhe 'DKA dhe shkolla kanë hartuar/miratuar listën për zëvendësim të përkohshëm të stafit të shkollës' zbatuar 49.87%.

Nënmasat e zbatuara më pak se 50%




Figura 3. Nënmasat e zbatuara më pak se 50% në nivel vendi

Sa i përket zbatimit të masave anti Covid-19 nga shkollat në secilën komunë, nga figura 4 vërejmë se komunat me performancën më të mirë përfshijnë: Junikun ku masat ku masat janë zbatuar 94.9%, përcjellur nga komunat e Gllogocit (89.3%), Ferizajit (88.3%), Rahovecit (87.3%), dhe Lipjanit, Prizrenit, Skënderajit, dhe Gjakovës ku masat janë zbatuar rreth 86%. Në anën tjetër, komunat me performancën më të dobët sa i përket zbatimit të masave anti Covid-19 gjatë kësaj periudhe përfshijnë komunën e Leposaviqit dhe atë të Shtërpcës ku masat janë zbatuar vetëm 50.93% dhe 55.59% respektivisht.




Figura 4. Zbatimi i përgjithshëm i masave anti COVID-19 nga shkollat sipas komunave

Në figurën 5, ofrohet një pasqyrë më e detajuar, ajo e përmbushjes së secilës masë sipas komunës. Siç vërehet, të gjitha komunat përveç komunës së Leposaviqit nga katër masat anti Covid-19 më së miri kanë performuar në zbatimin e masës 'Taskforca në nivel institucioni parashkollor apo shkolle'. Sa i përket zbatimit të 'Masat parandaluese: testimi, raportimi i rasteve me COVID-19 dhe ndërprerja e mësimit' shumica e komunave, përfshirë: Junikut, Deçanin, Gjilanin, Ferizajin, Gjakovën, Glogocin, Istogun, Pejën, Rahovecin, Skënderajin, Prizrenin, dhe Vushtrrinë kanë zbatuar këtë masë më shumë sesa masat tjera. Ndërsa, komuna e Mamushës, ajo e Kllokotit, dhe Shtërpcës nuk kanë performuar aq mirë në këtë masë.

Komuna e Junikut, ajo e Glogocit, dhe Zubin Potokut kanë zbatuar mjaft mirë masën 'Masat parandaluese higjienike dhe mbrojtëse - Përgatitja e shkollës për fillimin e vitit shkollor'. Edhe komunat tjera kanë performuar mjaft mirë në zbatimin e kësaj mase, për dallim nga komuna e Shtërpcës, Leposaviqit, dhe ajo e Zveçanit. Në anën tjetër, masa e zbatuar më së paku nga të katër masat e vendosura mbetet 'Organizimi i procesit mësimor sipas tre skenarëve të paraqitur në udhëzuesin e MASH' e zbatuar më së shumti nga komuna e Junikut përcjellur pastaj nga Gjakova, Prishtina dhe Rahoveci. Masa më së paku është zbatuar nga komuna e Vitisë, Dragashit, dhe ajo e Shtërpcës.




Figura 5. Përmbushja e masave anti COVID-19 sipas masës dhe komunës

Në fund, figura 6 shfaq skenarët e adaptuar nga shkollat gjatë kohës së monitorimit, ku shihet se shumica e shkollave kanë punuar në skenarin A, dy komuna kanë punuar kryesisht në skenarin B kurse në kohën e monitorimit 5 komuna kanë pasur shkolla të cilat kanë punuar në skenarin C gjatë kohës kur janë monitoruar. Kjo nuk do të thotë që në komunat tjera nuk ka pasur mbyllje të shkollave apo kalim në skenarin C, por që në javët të cilat janë monitoruar është raportuar ky skenar.




Figura 6. Skenarët e adaptuar nga shkollat gjatë kohës së monitorimit

Në përgjithësi, shkollat dhe komunat kanë treguar mobilizim të lartë për zbatimin e masave anti Covid-19 të parapara nga MASH. Për zbatim më efikas të masave dhe përmirësim të vazhdueshëm të procesit mësimor nevojitet monitorim i vazhdueshëm dhe funksionim efikas i task forcave në nivel të shkollës, komunës, dhe MASH. Ajo çfarë është vërejtur gjatë procesit të monitorimit është se nevojitet koordinim më i mirë mes MASH dhe komunave sa i përket mënyrës së dokumentimit të procesit të vendimmarrjes nga taskforcat. Sa i përket masave higjienike, rekomandohet vëmendje e vazhdueshme, furnizim i rregullt dhe ndjekje e protokoleve të vendosura, me fokus të veçantë në mos lejimin e grumbullimit në oborre, hapësira përcjellëse, dhe mjete të transportit që bëjnë transportin e organizuar të nxënësve nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.

Për sa i përket raportimit të rasteve dhe regjistrimit të tyre në SMIA është vërejtur një përmirësim, por në të njëjtën kohë nevoja për përmirësim të mëtejshëm mbetet e dukshme. Për sa i përket organizimit të procesit mësimor, nevojitet përmirësim i kushteve për zbatimin e skenarit B dhe C, me theks të veçantë në ngritje të kapacitetit për digjitalizim në nivel shkollë dhe ngritje të shkathtësive digjitale të menaxhmentit, mësimdhënësve, dhe nxënësve.

Gjatë procesit të monitorimit, kemi vërejtur edhe përmirësime të disa aspekteve në nivel shkollë, sidomos në lidhje me shtrirjen e rrjetit të internetit apo sigurimin e pajisjeve, por vlen të theksohet se raporti i monitorimit për shkolla paraqet vlerësimin në momentin e realizimit të vizitës.

Në fund, raporti nuk ka mundur të paraqesë me saktësi informatat demografike për secilën shkollë si dhe të bëjë analiza më të thella që do të mund të bëheshin sikur të ishin siguruar të dhëna të sakta rreth numrit të nxënësve dhe numrit të të infektuarëve brenda shkollave gjatë kësaj kohe. Për këtë arsye, Edutask dhe BIRN mbesin të dedikuar të bashkëpunojnë me shkollat dhe autoritetet komunale dhe qendrore për të vazhduar monitorimin si dhe për të pasuruar platformën me të dhëna tjera të rëndësishme për shkollat.



**RAPORTI PËRMBLEDHËS I
MONITORIMIT TË ZBATIMIT
TË MASAVE ANTI COVID-19
NGA SHKOLLAT NË KOSOVË**

SHTATOR-DHJETOR 2020